



UNË, TI, NE

CENSI I POPULLSISË DHE BANESAVE NË SHQIPËRI 2023

Qarqe / Bashki

ALBANIA POPULATION AND HOUSING CENSUS 2023

Prefectures / Municipalities

📍 **DIBRA**

 **DIBRA**

CENSI I POPULLSISË DHE BANESAVE NË SHQIPËRI 2023

Qarqe / Bashki

*ALBANIA POPULATION AND
HOUSING CENSUS 2023*

Prefectures / Municipalities



CENSI I POPULLSISË DHE BANESAVE NË SHQIPËRI 2023 – QARQE / BASHKI
ALBANIA POPULATION AND HOUSING CENSUS 2023 – PREFECTURES / MUNICIPALITIES

DIBRA

Drejt看 botimi/Director of the Publication: Dr. Elsa Dhuli

Në përgatitjen e këtij botimi kontribuan/ This publication was prepared by:
E.Sevrani; A.Omuri (Muça); A.Xhikneli; H.Mitre; I.Mustafa; E.Dhamo; B.Muja; A.Berbiu; E.Subashi; J.Kostaqi;
D.Delaj; I.Gorce; B.Memaj; E.Zhapa; V.Breçani; D.Bela; S.Hasmujaj; L.Seferkolli; A.Petriti; V.Çelaj.

© Copyright: INSTAT 2024

Ndalohet riprodhimi i këtij botimi apo transmetimi i tij në cilëndo formë, pa autorizim
paraprak me shkrim të mbajtësit të së drejtës së autorit nga INSTAT.

*No part of this publication can be reproduced or transmitted in any form or by
any means without the prior written permission of the copyright holder.*

INSTITUTI I STATISTIKAVE
Rr. Vllazën Huta,
Ndërtesa 35, Hyrja 1
Tiranë, Kodi Postar 1017
Tel: + 2233356 / 2222411 4 355
Fax: 411 2222 4 355+
e-mail: info@instat.gov.al
www.instat.gov.al

Design: Gentian Suçi

*The views and conclusions contained in this publication do not
necessarily reflect those of the European Union or the Swiss government.*

PARATHËNIE

Instituti i Statistikave, pas publikimit të Rezultateve kryesore të Cens 2023, ofron për publikun dhe gjithë përdoruesit, publikimin e rezultateve të dedikuara, për çdo qark dhe bashkitë përkatëse. Këto të dhëna ju vijnë në ndihmë përdoruesve për të kuptuar situatën demografike dhe karakteristikat e saj, nivelin arsimor dhe shëndetësor në rajone të ndryshme të vendit. Do të jenë dymbëdhjetë publikime, të dedikuara për çdo qark, të cilat do të kenë në përmbajtje të dhëna për bashkitë dhe njësitë administrative të tyre.

Ky informacion është i vlefshëm për hartuesit e politikave dhe vendimarrësve, duke i ndihmuar ata në hartimin e strategjive zhvillimore në nivel vendor, përmirësimin e infrastrukturës dhe studimin e nivelit socio-ekonomik apo të kushteve të banimit të qarqeve/bashkive në vend. Bazuar në këto të dhëna mund të vlerësohen politikat ekzistuese dhe të hartohen politika të reja, për të adresuar ndryshimet demografike të ndodhura në dekadat e fundit në vendin tonë.

Censi i Popullsisë dhe Banesave 2023 është i treti aktivitet i organizuar nga INSTAT pas viteve 1990 dhe i dymbëdhjeti në historinë e Censeve në vend, prej vitit 1913. Ky proces, i cili konsiderohet si aktiviteti statistikor më i rëndësishëm, kryhet çdo 10 vjet për të paraqitur në një moment të caktuar, situatën demografike të popullsisë banuese në vend. Censi i Popullsisë dhe Banesave, u realizua në përputhje me ligjin Nr.140/2020 dhe në ndjekje të rekomandimeve të Kombeve të Bashkuara për Censet e raundit 2020, si dhe rregulloret e Komisionit Evropian, për kryerjen e tyre. Data 18 Shtator 2023, është përcaktuar si momenti i fotografimit të popullsisë banuese në Shqipëri.

Çdo Cens paraqet sfida, risi dhe zhvillime, në çdo kohë apo moment që kryhet. Në Cens 2023, u përballuan shumë sfida të paparashikuara, si tërmeti i vitit 2019, pandemia globale Covid-19, ngjarjet elektorale në vend, si dhe lufta dhe kriza e çmimeve. Sfida të tjera që ky proces në vetvete mban, përfshinin zhvillimet teknologjike apo mbulimi i të gjitha zonave, nga skajet më të largëta deri te zonat e mbipoplluara. Pavarësisht këtyre sfidave, INSTAT u angazhua në realizimin me

PREFACE

The Institute of Statistics, following the publication of the main results of the 2023 Census, offers the public and all users dedicated publications for each region and their respective municipalities. These data helps users understand the demographic situation and its characteristics, educational, and health levels in various regions of the country. There will be twelve publications, dedicated to each prefecture, containing data for their municipalities and administrative units.

This information is valuable for policy makers and decision makers, aiding them in drafting development strategies at the local level, improving infrastructure, and studying the socio-economic level or living conditions in the prefectures/municipalities of the country. Based on these data, existing policies can be evaluated, and new policies can be designed to address demographic changes that have occurred in recent decades in our country.

The 2023 Population and Housing Census is the third activity organized by INSTAT since the 1990s and the twelfth in the history of Censuses in the country, since 1913. This process, considered the most important statistical activity, is conducted every 10 years to present, at a specific moment, the demographic situation of the resident population in the country. The Population and Housing Census was conducted in accordance with Law No.140/2020 and in adherence to the United Nations recommendations for the 2020 round of Censuses, as well as the regulations of the European Commission for conducting them. September 18, 2023, is designated as the moment for capturing the resident population in Albania.

Each Census presents challenges, innovations, and developments, at every time or moment they are conducted. The 2023 Census faced many unforeseen challenges, such as the 2019 earthquake, the global Covid-19 pandemic, electoral events in the country, as well as the war and price crisis. Other challenges inherent in the process included technological developments and covering all areas, from the most remote to the densely populated ones.

sukses të veprimtarisë së Censit duke përmbushur të gjitha pritshmëritë. Censi 2023 solli inovacione të rëndësishme, duke përfshirë: i) përdorimin e teknologjisë së informacionit në mbledhjen e të dhënave; ii) një sistem gjeohapësinor të digjitalizuar; iii) monitorimin në kohë reale të ecurisë dhe cilësisë së mbledhjes së të dhënave; iv) një gamë më të gjerë informacioni të mbledhur.

Publikimet në nivel qarku dhe bashkie, do të vijojnë me publikime të tjera, të cilat lidhen me rishikimin e popullsisë nga viti 2023-2012, si dhe projeksionet e popullsisë dhe strukturën demografike për njëzet vitet e ardhshme. Duke vijuar më tej, me një sërë studimesh dhe analizash, mbi tematika të ndryshme, si lëvizjet e brendshme apo të migracionit, nivelet e arsimit të fëmijëve dhe të rinjve, kushtet e banimit, tipologjia e ndërtesave dhe banesave, dhe të tjera. Këto studime dhe analiza do të shërbejnë për përdoruesit si një burim informacioni për të ndërtuar një të ardhme më të mirë, më të barabartë dhe të qëndrueshme për të gjithë shoqërinë.

Në emër të INSTAT dhe të gjithë ekipit të Censit, shpreh mirënjohjen time më të thellë për të gjithë ata që luajtën rol në këtë përpjekje historike, duke kontribuar në trashëgiminë e qëndrueshme të vendit tonë!

Despite these challenges, INSTAT was committed to successfully completing the Census operation, meeting all expectations.

The 2023 Census brought significant innovations, including: i) the use of information technology in data collection; ii) a digitized geospatial system; iii) real-time monitoring of the progress and quality of data collection; iv) a wider range of collected information.

Publications at prefectures and municipality level will be followed by others, related to the revision of the population from 2023 to 2012, as well as population projections and demographic structure for the next twenty years. Furthermore, a series of studies and analyses will be published on various topics, such as internal movements or migration, education levels of children and youth, housing conditions, typology of buildings and dwellings, and more. These studies and analyses will serve users as a source of information to build a better, more equal, and sustainable future for the entire society.

On behalf of INSTAT and the entire Census team, I express my deepest gratitude to all those who played a role in this historic effort, contributing to the sustainable heritage of our country!

Dr. Elsa DHULI
DREJTOR I PËRGJITHSHËM
GENERAL DIRECTOR



FALENDERIME

Instituti i Statistikave, ju shpreh falenderime dhe mirënjohje të sinqerta!

Qytetarëve, të çdo qarku apo bashkie, për kontributin e dhënë deri në përfundimin me sukses të këtij aktiviteti, duke dhënë informacione për veten dhe familjarët e tyre, si dhe për ndërtesat dhe banesat. Ata hapën dyert për punonjësit tanë të terrenit dhe bashkëpunuan ngushtë me ta.

Qeverisë shqiptare, për mbështetjen e vazhdueshme financiare, administrative dhe logjistike, e cila mundësoi realizimin me sukses të këtij aktiviteti madhor pavarësisht sfidave të ndryshme.

Partnerëve tanë evropianë dhe ndërkombëtarë, të cilët përmes mbështetjes financiare dhe asistencës teknike, bënë të mundur që ky proces të zhvillohet në përputhje me rekomandimet dhe standartet ndërkombëtare. Bashkëpunimi me ta shprehu partneritet dhe transparencë.

Komisionit Qendror të Cens, si një njësi mbështetëse dhe këshilluese në këtë proces, i cili lehtësoi vendimmarrjen, administrimin dhe logjistikën për INSTAT.

Komisionet e Cens në nivel Bashkie, të cilët na mbështetën nga ana logjistike, dhe lehtësuan procesin e rekrutimit të burimeve njerëzore, duke ndihmuar ekzekutimin dhe kryerjen e fazave të ndryshme të këtij zinxhiri aktivitetesh.

Një falenderim i veçantë shkon për *anketuesit, kontrollorët, mbikqyrësit*, të cilët të zgjedhur nga çdo njësi administrative apo bashki, mblodhën të dhënat në kushte sfiduese në terrenet e largëta dhe malore, në zonat e mbipopulluara, me teknologjinë dhe kompleksitetin e pyetjeve, duke siguruar informacione thelbësore për popullsinë, ndërtesat dhe banesat për çdo njësi administrative apo bashki të tyre.

ACKNOWLEDGEMENTS

The Institute of Statistics express its sincere gratitude and thanks.

To the citizens for their contribution to the successful completion of this process, by providing information about themselves and their household members, as well as about the buildings and dwellings in Albania. They opened their doors to our field workers and collaborated closely.

To the Government of Albania for continuous financial, administrative, and logistical support, which enabled the successful implementation of this major activity despite various challenges.

To our European and international partners, through financial support and technical assistance, which made it possible to conduct this process in accordance with international recommendations and standards. The collaboration with them showed partnership and transparency.

To the Central Census Commission, as a supporting and advisory unit in this process to facilitate decision-making, administration, and logistics for INSTAT.

To the Municipality Census Commissions that supported INSTAT logistically and facilitated the human resources recruitment process, easing the execution of the various stages of this activity chain.

Special thanks go to the *enumerators, supervisors, and controllers* who, together, collected essential data under challenging field conditions, technological limitations, and procedural complexities, ensuring crucial information about Albania's population, buildings, and dwellings for each municipality and their administrative units.

Vlerësojmë punën e *ekspertëve të asistencës teknike*, të siguruar nga vendet e Bashkimit Evropian, pjesë përbërëse e këtij procesi, të cilët mbështetën dhe inkurajuan ekspertët e INSTAT për të arritur me sukses objektivat e vendosur.

Së fundmi, por jo më pak të rëndësishëm, vlerësojmë përkushtimin, seriozitetin, dhe profesionalizmin e çdo *punonjësi* të INSTAT dhe Zyrave Rajonale Statistikore, të cilët planifikuan, organizuan dhe zbatuan në mënyrë metodike një numër shumë të madh detyrash në mbledhjen e informacionit, në përpunimin dhe përgatitjen e gamës së gjerë të të dhënave, të paraqitura në publikimin: Rezultate kryesore të Cens dhe në dymbëdhjetë publikimet e dedikuara për çdo qark dhe bashki.

We appreciate *the technical assistance work*, integral to this process, which supported and encouraged INSTAT experts to successfully achieve their goals.

Last, but not least important, we commend the dedication, seriousness, and professionalism of *INSTAT employees* who methodically planned, organised and implemented a very large number of Census tasks, and processed and prepared the broad range of data that are featured in the main publication of the Main Results of Census and in twelve publications dedicated to each prefecture and municipality.


PROFIL: QARKU DIBËR
 PROFILE: DIBËR PREFECTURE



Dendësia e popullsisë në Qarkun e Dibrës është 41,4 banorë/km².

Population density of Diber prefecture is 41.4 inhabitants per km².

Numri i popullsisë më 18 Shtator 2023 <i>Population number on September 18th 2023</i>	107 178
Shpërndarja e popullsisë sipas gjinisë (%): <i>Gender population distribution:</i>	
Meshkuj/Male	50,4
Femra/Female	49,6
Popullsia me status martesor i/e martuar (%) <i>Population with marital status married</i>	53,7
Popullsia 15 vjeç e lart që kanë përfunduar ose janë duke e ndjekur shkollën (%) <i>Population aged 15 and over have either completed any level of education or are currently attending school</i>	96,2
Ndërtesa për qëllime banimi (Numër) <i>Buildings for residential purposes (Number)</i>	26 486
Banesa të zakonshme të banuara (Numër) <i>Conventional inhabited dwellings (Number)</i>	24 101
Njësi Ekonomike Familjare (Numër) <i>Households (Number)</i>	25 128





● Qendër qarku
□ Kufi qarku
□ Kufi bashkie

Burimi i kufijve administrative:
Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG)

DIBËR	Numri i popullsisë më 18 Shtator 2023 <i>Population number on September 18th 2023</i>	Shpërndarja e popullsisë sipas gjinisë (%) <i>Gender population distribution (%)</i>		Ndërtesa për qëllime banimi (Numër)/ <i>Buildings for residential purposes (Number)</i>	Banesa të zakonshme të banuara (Numër)/ <i>Conventional inhabited dwellings (Number)</i>	Njësi Ekonomike Familjare (Numër)/ <i>Households (Number)</i>
		Meshkuj <i>Male</i>	Femra <i>Female</i>			
Bulqizë	26 826	50,7	49,3	5 822	5 611	5 814
Dibër	50 775	50,3	49,7	12 114	10 070	10 455
Klos	12 172	50,2	49,8	3 682	3 051	3 279
Mat	17 405	50,5	49,5	4 868	5 369	5 580

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	5
FALENDERIME	7
PROFIL: QARKU DIBËR	9
PËRMBAJTJA	11
LISTA E AKRONIMEVE	12
HYRJE	13
1. METODOLOGJIA E CENSIT	15
ANEKSI I: MODULET DHE TEMAT E PYETËSORIT PËR NJËSITË EKONOMIKE FAMILJARE	28
ANEKSI II: KONCEPTE DHE PËRKUFIZIMET KRYESORE TË CENSIT	34
2. TABELAT	38

CONTENTS

PREFACE	5
ACKNOWLEDGEMENTS	7
PROFILE: DIBËR PREFECTURE	9
CONTENTS	11
ABBREVIATIONS	12
INTRODUCTION	13
1. CENSUS METHODOLOGY	15
ANNEX I: PRIVATE HOUSEHOLD QUESTIONNAIRE MODULES AND TOPICS	28
ANNEX II: MAIN CENSUS CONCEPTS AND DEFINITIONS	34
2. TABLES	38

LISTA E AKRONIMEVE

APC – Anketa Pas Cens

BE – Bashkimi Evropian

CAPI – Intervistë Personale direkte e Asistuar nga Kompjuteri

CSPro – Sistemi i përpunimit të Censit dhe Vrojtimeve

CPB – Cens i Popullsisë dhe Banesave

GIS – Sistemi i Informacionit Gjeografikë

INSTAT – Instituti i Statistikave të Shqipërisë

KE – Këshilli Evropian

KZS– Kontrolli i Zbulimit Statistikor

NjEF – Njësi Ekonomike Familjare

TI – Teknologjia e Informacionit

SVD – Sistemi i Vlerësimit të Dyanshëm

UNECE – Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën

ZC – Zonë Censi

ZRS – Zyra Rajonale e Statistikës

ABBREVIATIONS

CSPro - Census and Survey Processing System

CAPI - Computer Assisted Personal Interview

EA - Enumeration area

EC - European Council

EU - European Union

GIS - Geographical Information System

INSTAT - Albanian Institute of Statistics

ISCED - International Standard Classification of Education

IT - Information Technology

PES - Post Enumeration Survey

DSE - Dual System Estimation

PHC - Population and Housing Census

UNECE - United Nations Economic Commission for Europe

RSO – Regional Statistics Office

SDC– Statistical Disclosure Control

HYRJE

Censi i Popullsisë dhe Banesave 2023 (më tej referuar si Censi) konsiderohet si fotografia demografike dhe socio-ekonomike e popullsisë banuese në Shqipëri. Momenti i referencës së kësaj fotografie u përcaktua data 18 Shtator 2023, ora 00:00. I renditur i dymbëdhjeti në sekuencën e Censeve të kryera në Shqipëri, në harkun kohor prej 100 vjetësh, ky Cens ofron të dhëna të rëndësishme për strukturën demografike, karakteristikat sociale dhe ekonomike, karakteristikat e banesës, ndërtesat dhe kushtet e jetesës së njësive ekonomike familjare në nivel qendror dhe vendor. Informacioni i siguruar nga ky Cens do të shërbejë për hartimin e planeve për investime infrastrukturore, për planifikime në fushën e arsimit, shëndetësisë, transportit dhe fusha të tjera socio-ekonomike, në përmbushje të nevojave të komunitetit. Metodologjia për kryerjen dhe zbatimin e Censit bazohet në rekomandimet ndërkombëtare të Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Evropën (UNECE) për raundin e Censeve të vitit 2020 dhe është në përputhje me Rregulloren (KE) Nr. 763/2008 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian të datës 9 korrik 2008 për Censet e popullsisë dhe banesave, si edhe akte të tjera ligjore. Në përputhje me këto standarde ndërkombëtare, u zbatua koncepti i “vendbanimit të zakonshëm” brenda territorit të Shqipërisë.

Metodat e mbledhjes së të dhënave, infrastruktura e TI, sistemet hartografike, logjistika dhe fushata e komunikimit zbatuan Strategjinë e Censit të hartuar nga INSTAT dhe ekspertë të asistencës teknike. Organizimi dhe funksionimi i Censit mbështetet në ligjin Nr.140/2020 “Për Censin e Popullsisë dhe Banesave”, ligjin Nr.17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”, ligjin Nr.9887 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe aktet ligjore përkatëse, përfshirë Vendimet Nr.3/2023 dhe Nr. 15/2024, të Kuvendit të Shqipërisë, lidhur me Planin Vjetor të INSTAT, 2023 dhe 2024. Në bazë të këtyre akteve ligjore, punonjësit, mbikëqyrësit, kontrollorët, anketuesit dhe punonjësit mbështetës të INSTAT-it u ngarkuan për të organizuar Censin dhe mbledhjen e të dhënave. Rreth 6 800 punonjës në terren dhe 200 punonjës të INSTAT u angazhuan për të mbledhur informacion për 5 240 zona Censi. INSTAT ishte institucioni kryesor përgjegjës për përgatitjen, organizimin dhe zbatimin e Censit 2023, por për kryerjen me

INTRODUCTION

The Population and Housing Census 2023 (hereafter referred to as the Census) is considered the demographic and socio-economic snapshot of the resident population and Albania. The reference moment of this snapshot was set for September 18, 2023, at 00:00. Ranked twelfth in the sequence of Censuses conducted in Albania over the span of 100 years, this Census offers important data on the demographic structure, social and economic characteristics, housing features, buildings, and living conditions of households at both central and local levels. The information provided by this Census will serve for drafting plans, investments in planning education, health, transportation, and other socio-economic areas, to meet community needs. The methodology for conducting and implementing the Census is based on the international recommendations of the United Nations Economic Commission for Europe (UNECE) for the 2020 Census round, and is in line with Regulation (EC) No. 763/2008 of the European Parliament and Council of July 9, 2008, on Population and Housing Censuses and other legal acts. In accordance with these international standards, the concept of ‘usual residence’ within the country’s territory was applied.

The methods for data collection, IT infrastructure, cartographic systems, logistics, and the communication campaign were based on the Census Strategy developed by INSTAT and technical assistance experts. The organisation and functioning of the Census process are supported by Law No. 140/2020 “On Population and Housing Census” and Law No. 17/2018 “On Official Statistics,” and related legislative acts, including Decisions No3/2023 and No. 15/2024, of the Parliament of Albania, related to INSTAT’s Annual Plan 2023-2024. Based on these legislative acts, INSTAT employees, supervisors, controllers, enumerators and support staff were assigned to the Census organisation and data collection. Approximately 6,800 field workers and 200 INSTAT employees were engaged to gather information for 5,240 enumeration areas. INSTAT was the primary responsible agency for the preparation, organisation, and implementation of the 2023 Census, but for the successful implementation of such a national-scale statistical operation, cooperation with and support from central and local administrative institutions was crucial. Based on the

sukses të një operacioni të tillë statistikor në shkallë kombëtare, bashkëpunimi dhe mbështetja nga institucionet administrative qendrore dhe vendore ishte thelbësore. Bazuar në Ligjin e Censit, Komisioni Qendror i Censit dhe Komisionet e Censit në Nivel Bashkie u krijuan si instrumente ndihmëse dhe mbështetëse në këtë proces. Ministri të ndryshme si: Ministria e Financave, Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit, ofruan mbështetje logjistike, si dhe ndihmuan për numërimin e kategorive të veçanta të popullsisë. Mbështetja teknike dhe financiare e Censit u mundësua nga Qeveria Shqiptare, Komisioni Evropian nëpërmjet Programit Kombëtar Shumë Përfitues 2014, si dhe Ambasada Suedeze, Ambasada Zvicerane dhe agjencitë e Kombeve të Bashkuara.

Ky publikim mbi Censin e Popullsisë dhe Banesave 2023 është i strukturuar në dy kapituj kryesorë. Pas hyrjes, *kapitulli i parë* detajon metodologjinë e përdorur në Cens, duke mbuluar përgatitjet, procedurat e mbledhjes së të dhënave, kornizën ligjore, aspektet logjistike, teknologjitë e informacionit dhe gjeohapësinore, përmbajtjen e pyetësorit dhe masat për ruajtjen e konfidencialitetit dhe sigurinë e të dhënave. *Kapitulli i dytë* vazhdon me tabelat, të cilat ofrojnë informacion mbi strukturën demografike, nivelet arsimore, statusin martesor, bërthamat familjare, përbërjen etnike, fenë dhe gjuhën, njësitë ekonomike familjare, ndërtesa, banesa, në nivel qarku, duke vijuar me strukturën demografike, nivelin arsimor, njësitë ekonomike familjare, bërthamat familjare, ndërtesat, banesat, në nivel bashkie dhe strukturën demografike, statusin martesor dhe pajisjet dhe shërbimet afatgjata të njësive ekonomike familjare dhe shërbimet bazë të banesës, në nivel njësie administrative.

Census Law, the Central Census Commission and Municipality Census Commissions were established as auxiliary and supportive instruments in this process. Various ministries – Ministry of Finance, Ministry of Interior, Ministry of Defence, Ministry of Justice, Ministry of Education and Sports – provided support for the enumeration of specific categories of the population. Technical and financial support to the Census was provided by the Albanian Government, the European Commission through the Multi-Beneficiary National Programme 2014, as well as the Swedish Embassy, the Swiss Embassy, and United Nations agencies.

This publication on the Population and Housing Census 2023 is structured into two main chapters. After the introductory, chapter one presents details the methodology used in the Census, covering preparations, data collection procedures, legal frameworks, logistical aspects, IT and geospatial technologies, questionnaire content, and measures ensuring confidentiality and data security. After the narrative chapters and the Census methodology description, the report continues with selected thematic maps and main results tables. Chapter two continues with tables, which provide information on demographic structure, educational levels, marital status, family nucleus, ethnicity, religion and language, households, buildings, dwellings, at prefecture level, following demographic structure, educational level, households, family nucleus, buildings, dwellings, at municipality level and demographic structure, marital status and amenities and household's services, at administrative unit level.

1. METODOLOGJIA E CENSIT

1.1 Baza ligjore

Baza ligjore e Censit të Popullsisë dhe Banesave dhe roli i INSTAT përcaktohen nga Ligji Nr.17/2018 për Statistikat Zyrtare, Ligji 140/2020 për Censin e Popullsisë dhe Banesave dhe Ligji Nr.9887 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ligji për Statistikat Zyrtare, ndër të tjera, përcakton se prodhimi dhe shpërndarja e statistikave zyrtare udhëhiqet nga parimet e Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane dhe në përputhje me Kornizën e Sigurimit të Cilësisë të Sistemit Statistikor Evropian. Ligji për Censin e Popullsisë dhe Banesave, ndër të tjera, ngarkon INSTAT me përgjegjësinë për organizimin dhe zbatimin e Censit të Popullsisë dhe Banesave, me mbështetjen e Komisionit Qendror të Censit dhe Komisioneve të Censit pranë Bashkive. Ai gjithashtu specifikon kategoritë e tjera të informacionit që duhet të mblidhen dhe natyrën e detyrueshme të pyetjeve të Censit, si dhe të drejtën për mos t'u përgjigjur për pyetjet mbi vetidentifikimin etnik, fenë dhe gjuhën. Përzgjedhja e temave të mbuluara nga Censi i vitit 2023 është plotësisht në përputhje me legjislacionin e BE për Censet e popullsisë dhe banesave të vitit 2021. Në përputhje me këto ligje, Plani Vjetor 2023 për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare, miratuar me vendimin e Kuvendit Nr. 3/2023, përcaktonte si moment të Censit mesnatën e 17-18 Shtatorit 2023 dhe periudhën e numërimit në terren nga 18 Shtator deri më 29 Tetor 2023. Në Planin Vjetor të vitit 2024 (Vendimi Nr. 15/2024) është përcaktuar periudha e publikimit të Rezultateve kryesore të Censit në Qershor 2024 dhe Rezultatet e Censit në nivel Qarku dhe Bashkie, në Tetor 2024.

1.2 Metodologjia e përgjithshme e Censit

Censi i Popullsisë dhe Banesave 2023 në Shqipëri ishte një Cens tradicional në kuptimin e mbulimit të të gjithë territorit, duke shkuar në çdo banesë dhe NjEF dhe duke mbledhur informacion për të gjithë individët, brenda një periudhe kohore të shkurtër të paracaktuar. Risitë kryesore në krahasim me Censet e mëparshme në Shqipëri konsistonin në përdorimin e intervistave personale të asistuar me

1. CENSUS METHODOLOGY

1.1 Legal basis

The legal basis of the Population and Housing Census and the position of INSTAT is provided by the Law No.17/2018 on Official Statistics, the Law 140/2020 on Census of Population and Housing and the Law No. 9887 on Protection of Personal Data. The Law on Official Statistics, among other things, sets forth that the production and dissemination of official statistics are guided by the principles of the European Statistics Code of Practice and in line with the Quality Assurance Framework of the European Statistical System. The Law on Census of Population and Housing, among other things, delegates the responsibility for the organisation and implementation of the Population and Housing to INSTAT, with the support of the Central Census Commission and Municipality Census Commissions. It also specifies the broad categories of information that should be produced by the Census and the mandatory nature of the Census questions and the right to self-identification for questions on ethnic identity, language and religion. The selection of topics covered by the 2023 Census is fully compliant with the EU legislation on the 2021 population and housing Censuses. The Law on Protection of Personal Data defines the rules for the protection and legal processing of the personal data. In line with these laws, the 2023 Annual plan for the implementation of the Official Statistics Program, approved by the parliament decision No. 3/2023, specified the Census reference moment for midnight of the night of 17 to 18 September 2023 and the enumeration period for 18 September to 29 October 2023. The 2024 Annual plan (Decision No.15/2024) stated that the main results of the Census will be published in June 2024 and the results of Census in prefecture and municipality level on October 2024.

1.2 General Census methodology

The Albania Population and Housing Census 2023 was a traditional Census in the sense of canvassing the entire country, reaching every single dwelling and household, and collecting information on all eligible individuals within a brief stipulated

kompjuter dhe hartave digjitale interaktive. Në përputhje me Censin e mëparshëm dhe rekomandimet për Censet e popullsisë dhe banesave të vitit 2020, Censi i vitit 2023 u krye sipas parimit të Censit de-jure. Popullsia e numëruar në Cens ishin ata individë që kishin vendbanimin e tyre të zakonshëm në Republikën e Shqipërisë në momentin e Censit dhe kishin banuar ose synonin të banonin atje për një periudhë të vazhdueshme kohore prej të paktën 12 muajsh. Rrjedhimisht, individët u numëruan në vendbanimin e tyre të zakonshëm, të përcaktuar si vendi gjeografik ku individët e numëruar zakonisht kalonin pushimin e tyre ditor, të vlerësuar për një periudhë 12 mujore, duke përfshirë momentin e Censit, pavarësisht nëse ata ishin apo jo të pranishëm në momentin e Censit.

Censi i Popullsisë dhe Banesave 2023 kishte për qëllim katër njësi statistikore për të cilat u krye një numërim i plotë dhe u mbledh informacion i detajuar:

- Individët që ishin banorë të zakonshëm në Shqipëri në momentin e Censit, pavarësisht nëse ishin shtetas të Republikës së Shqipërisë ose jo;
- Njëf, të përcaktuara si një grup individësh që jetojnë së bashku në një banesë dhe që ndajnë pjesërisht ose plotësisht një ekonomi të përbashkët ose një person i vetëm që siguron ushqimin e tij/saj, akomodimin dhe elementët e tjerë thelbësorë për të jetuar, pa asnjë person tjetër;
- Banesat e zakonshme, pavarësisht nëse këto ishin apo jo të banuara në kohën e Censit;
- Banesa kolektive, të përcaktuara si ambiente që janë projektuar për banim nga grupe të mëdha individësh ose disa Njëf dhe që janë përdorur si vendbanimi i zakonshëm i të paktën një individi në momentin e Censit.

period of time. The main innovations compared to previous Censuses in Albania consisted of the use of computer-assisted personal interviewing (CAPI) and interactive digital maps. In line with the previous Census and the Recommendations for the 2020 Censuses of Population and Housing, the 2023 Census was conducted according to the principle of a de-jure Census. The population enumerated in the Census were those persons who had their place of usual residence in the Republic of Albania at the Census reference moment and had lived, or intended to live, there for a continuous period of time of at least 12 months. Accordingly, people were enumerated at their place of usual residence, defined as the geographic place where the enumerated person usually spent their daily rest, assessed over the reference period of 12 months including the Census reference moment, whether or not they were present there at the Census reference moment.

The Population and Housing Census 2023 targeted four Census units for which a complete enumeration was conducted and detailed information was collected:

- Persons who were usual residents in Albania on the Census moment, irrespective of whether they were citizens of the Republic of Albania;
- Households, defined as a group of persons who live together in a dwelling and who share a partially or fully joint economy or a single person who makes provision for his or her own food, accommodation and other essentials for living without combining with any other person;
- Conventional dwellings, whether or not these were inhabited at the time of the Census;
- Collective living quarters, defined as the premises that are designed for habitation by large groups of individuals or several households, and which were used as the usual residence of at least one person at the time of the Census.

Për më tepër, Censi gjithashtu mblodhi disa informacione për individët e pranishëm përkohësisht (vizitorët), ish-banorët zakonisht rezidentë që jetonin jashtë vendit në kohën e Censit, banesat jo të zakonshme (njësi të tjera banimi) dhe ndërtesat. Inventari i plotë i ndërtesave në vend u përdor si bazë për identifikimin se ku ndodheshin njësitë e Censit.

1.3 Logjistika e Censit dhe punonjësit e terrenit

Organizimi i logjistikës është ndër sfidat më të mëdha me të cilat përballlet një Cens, për shkak të madhësisë së tij. Operacionet logjistike të Censit kërkonin planifikim të gjerë dhe shpërndarje të burimeve dhe përfshinin një gamë të gjerë përgjegjësisish, nga planifikimi dhe sigurimi i zyrave të punës dhe ambienteve të trajnimit deri te transportimi i pajisjeve të trajnimit e materialeve në terren dhe menaxhimi i zgjidhjeve të sigurta të ruajtjes së pajisjeve. Në mbështetje të punës në terren, u planifikuan dhe u siguruan automjete në nivel bashkie dhe qarku, duke mundësuar mbulim të plotë të të gjithë territorit. Censi i Popullsisë dhe Banesave në Shqipëri, 2023 në qarkun Dibër punësoi rreth 215 punonjës të përkohshëm për të kryer mbledhjen/monitorimin e të dhënave në terren.

Detyrat e ndryshme në terren u kryen nga kategoritë e mëposhtme të punonjësve:

- Anketuesit (176), përgjegjës për numërimin e banesave, NjEF dhe individëve në ZC, që u ishte caktuar duke përdorur pyetësoin elektronik për NjEF private;
- Kontrollorët (34), përgjegjës për punën e zakonisht të pesë anketuesve, duke monitoruar ecurinë e mbledhjes së të dhënave, siguruar respektimin e procedurave dhe duke ndihmuar për çdo problematikë që mund të lindte në terren;
- Mbikëqyrësit (5), përgjegjës për punën zakonisht të gjashtë kontrollorëve dhe 30 anketuesve, duke mbikëqyrur aktivitetet e tyre, duke u siguruar që operacionet në terren të kryheshin pa probleme dhe me efikasitet dhe duke ofruar mbështetje për zgjidhjen e problematikave komplekse;

In addition, the Census also collected some information about temporarily present persons (visitors), former usually resident persons who were living abroad at the time of the Census, non-conventional dwellings (other housing units) and buildings. The full inventory of buildings in the country was used as the basis for identifying where Census units were located to be enumerated.

1.3 Census logistics and field staff

Due to the size of the operation, among the biggest challenges faced during a Census is the orchestration of logistics. The Census logistics operations required extensive planning and resource allocation, and encompassed a wide range of responsibilities, from providing offices and training facilities, to transportation of training equipment and field materials, and managing secure storage solutions. To support the fieldwork, vehicles at the prefecture and municipality level were planned and provisioned, ensuring comprehensive coverage of the entire territory. The Population and Housing Census 2023, in Dibër prefecture, employed about 215 temporary staff to implement the census enumeration in the field.

The different tasks in the operation were performed by the following categories of field staff:

- Enumerators (176), responsible for enumerating the dwellings, households and persons in the EA assigned to them by using the electronic questionnaire for private households.
- Controllers (34), responsible for the work of usually five enumerators, by monitoring the progress of data collection, ensuring adherence to procedures and assisting with any issues that arose in the field.
- Supervisors (5), responsible for the work of usually six controllers and 30 enumerators, by overseeing their activities, ensuring that field operations were conducted smoothly and efficiently, and providing support to resolve complex issues.

- Punonjësi mbështetës i GIS (4), përgjegjës për çështjet e lidhura me hartat dhe problematika të hasura gjatë numërimit;
- Punonjësi mbështetës i TI (8), përgjegjës për përdorimin e duhur të infrastrukturës së TI gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave në terren.

Operacionet logjistike të INSTAT u ndihmuan nga Komanda Mbështetëse e Ministrisë së Mbrojtjes, e cila luajti një rol vendimtar në transportimin e materialeve të Censit për shpërndarje dhe grumbullim nga terreni. Krahas Ministrisë së Mbrojtjes, mbështetje të konsiderueshme u dha nga bashkitë dhe universitetet në të gjithë vendin. Bashkitë luajtën një rol vendimtar në sigurimin e mjediseve të trajnimit dhe punës për punonjësit e Censit, duke siguruar që operacionet logjistike të mund të vazhdonin pa probleme. Universitetet kontribuan me ofrimin e ambienteve për sesionet e trajnimit, duke ndihmuar efektivitetin e realizimit të tyre.

1.4 Afatet kohore të Censit dhe sfidat kryesore

Censi i Popullsisë dhe Banesave kishte për qëllim kryerjen e numërimit në intervalin e rregullt dhjetëvjeçar të Censeve dhe pajtueshmërinë me rregulloren e BE-së për vitin 2021, si vit referues i Censit. Rrethana të ndryshme bënë të nevojshëm modifikimin e këtij qëllimi. Fillimisht, Censi u afrua në vitin 2020 për të shmangur zgjedhjet elektorale të vitit 2021. Më pas, shpërthimi i pandemisë COVID-19 në vitin 2020 imponoi një shtyrje të Censit në vitin 2022, pasi aktivitetet zbatuese paraqisnin rreziqe shumë të larta për shëndetin e punonjësit të terrenit dhe të të anketuarve, si dhe për bashkëpunimin e popullsisë. Së fundi, vështirësitë teknike në procesin e sigurimit të tabletave për mbledhjen e të dhënave në terren shkaktuan një vonesë tjetër të Censit për vitin 2022. Përfundimisht, realizimi i Censit dhe shpërndarja e rezultateve kryesore të tij u kryen sipas planit kryesor të aktiviteteve në vijim, në vitin 2023. Aktivitetet përgatitore nisën në fillim të vitit 2019 me një inventar të nevojave për informacion midis aktorëve kryesorë, duke përfshirë pushtetin qendror dhe vendor, botën akademike, grupet e interesit, agjencitë ndërkombëtare dhe vendet partnere. Rezultatet e këtij inventarizimi u përfshinë në një draft-pyetësor dhe aplikacion CAPI, të cilat u testuan në një ushtrim për pilotimin e Censit në Tetor 2019.

- GIS support staff (4), responsible for mapping-related issues encountered during the enumeration.
- IT support staff (8), responsible for the proper use of IT infrastructure during the data collection process.

INSTAT's logistics operations were bolstered by the Support Command of the Ministry of Defence which played a crucial role in transporting Census materials for distribution to and collection from the field. In addition to the Ministry of Defence, significant support was received from municipalities and universities across the country. Municipalities played a crucial role in providing premises for the training and work of Census staff, ensuring that logistical operations could proceed smoothly in their respective areas. Universities contributed by offering facilities for training sessions, which greatly aided in the efficient of their conduction.

1.4 Census timeline and main challenges

The Population and Housing Census aimed at conducting the Census at the regular ten-year Census interval and compliance with the EU regulation for 2021 as the Census reference year. Several circumstances necessitated modifying this aim. Originally, the Census timing was advanced to 2020 to avoid interference with the 2021 national elections. Subsequently, the outbreak of the COVID-19 pandemic in 2020 imposed a postponement of the Census to 2022, as implementing activities presented too high risks to the health of Census staff and respondents, and for collaboration of the population. Finally, technical difficulties in the process of acquiring the tablets for the Census field staff caused another delay of the enumeration to 2022. In the end, the Census enumeration and the dissemination of the main Census results were realised according to the following main timeline of activities. Preparatory activities started early 2019 with an inventory of information needs among key stakeholders, including national and local governments, academia, interest groups, international agencies and donor countries. The outcomes of this inventory were accommodated in a draft questionnaire and CAPI application, which were tested in a pilot Census exercise in October 2019. In the same year, a country-wide inventory

Në të njëjtin vit, u bë një inventar i ndërtesave dhe banesave në mbarë vendin për të përgatitur gjeodatabazën e Censit duke siguruar elementet bazë për përcaktimin e Zonave të Censit (ZC) dhe prodhimin e hartave digjitale të tij. Tërmeti i Nëntorit të vitit 2019 solli nevojën për përditësime të mëtejshme të kësaj pune në terren. Shpërthimi i pandemisë COVID-19 në vitin 2020 shkaktoi një pezullim të aktiviteteve kryesore, ndonëse INSTAT vazhdoi një pjesë të përgatitjeve. Pavarësisht masave kufizuese, shumica e aktiviteteve rifilluan në fund të vitit 2020 me një riorientim të plotë në pyetësin e Censit dhe aplikacionin CAPI, ndër të tjera duke përfshirë gjetjet e pilotit të vitit 2019. Në vitin që pasoi, aktivitetet e Censit ndryshuan shpejtësinë e përgatitjeve për një pilot Cens të plotë në Tetor dhe Nëntor të vitit 2021.

Përveç testimit të brendshëm, para pilot Censit u kryen tre teste në terren, secili duke shtuar më shumë komponentë në instrumentin e Censit. Këto përfshinin aktivitetet e komunikimit, trajnimin në shkallë të plotë të punonjësve në terren, mbledhjen e të dhënave në banesat kolektive, procedurat e shkëmbimit të të dhënave, një mjet operativ monitorimi të punës në terren dhe një pilot APC në Dhjetor 2021. Aktivitetet në vitin 2022 u fokusuan në finalizimin e instrumentit për mbledhjen e të dhënave të Censit në muajt Shtator dhe Tetor, duke përfshirë finalizimin e përcaktimit të zonave të Censit dhe me vëmendje të shtuar në zhvillimin e fushatës së komunikimit e publicitetit për Censin, si dhe përzgjedhjen e rekrutimit e punonjësve në terren dhe personelit të përkohshëm mbështetës. Në vitin 2022, aktivitetet u reduktuan për rreth gjysmë viti si rrjedhojë e mospërfundimit të tabletave të Censit, dhe rifilluan përsëri në vitin 2023 me kryerjen e një testi përfundimtar në terren dhe përditësimin e instrumentit të Censit. Përgatitjet përfundimtare të Censit përfshinin ri-vizita të zonave ku pritej aktivitet i rëndësishëm ndërtimi për të përditësuar gjeodatabazën e Censit, zbatimin e fushatës së komunikimit e publicitetit dhe përzgjedhjen, rekrutimin dhe trajnimin e punonjësve në terren. Trajnimi u zhvillua në disa shkallë. Nga punonjësit e INSTAT me përvojë në operacionet statistikore, u zgjedhën 30 trajnerë kryesorë të cilët u trajnuan nga specialistë të Censit (Prill). Këta trajnerë kryesorë më pas trajnuan 122 trajnerë, të përbërë nga punonjësit e tjerë të INSTAT qendër dhe Zyrate rajonale statistikore (Korrik) dhe 170 mbikëqyrës (në fillim të muajit Gusht), në të cilin trajnuesit morën pjesë për të fituar më shumë përvojë në përmbajtjen dhe procedurat e Censit, si dhe materialet e trajnimit dhe

